



Kolegji ESLG

MEMORANDUM PËR BASHKPUNIM DHE NJOHJE TË NDËRSJELLTË

NDËRMJET

Kolegjit "ESLG"- Prishtinë

dhe

Shoqatës së Gjeodetëve të Kosovës

I. Qëllimi i Memorandumit

1. Me këtë memorandum palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin e mirë dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellët, duke synuar arritjen e standardeve evropiane të gjeodezisë, ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale të gjeodetëve dhe duke synuar ndërlidhjen e mësimit akademik në ESLG me punë praktike të gjeodetëve dhe anasjelltas;

II. Fushëveprimtaria

Bashkëpunimi i ndërsjellët i palëve do të realizohet në këto fusha:

1. Shoqata e Gjeodetëve të Kosovës zotohet se do të ofrojë këshillat e saj për përpilimin e planprogrameve moderne të lëndëve përkatëse në programin Menaxhimi i patundshmërive dhe Infrastrukturës niveli bachelor dhe master sipas kërkesave të Shoqatës së Gjeodetëve të Kosovës aty ku është e mundur;
2. Ofrimi i trajnimeve modulare nga ana e Kolegjit ESLG për gjeodetët e anëtarësuar në Shoqatën e Gjeodetëve të Kosovës sipas kërkesave të Shoqatës së Gjeodetëve dhe pranimi i këtyre module trajnuese si arsimim formal në formë të kredive ECTS në nivelin bachelor dhe master;
3. Stafii akademik i Kolegjit ESLG ofron ndihmën këshilldhënëse për Shoqatën e Gjeodetëve në fushën e legjislacionit të kadastrit, respektivisht në aspektet teknike që ndërlidhen me standardet evropiane të gjeodezisë;

4. Organizimi i përbashkët i aktiviteteve në fusha të ndryshme nëpërmjet simpoziumeve, konferencave, debateve rreth standardeve dhe praktikave më të mira në fushën e standardeve evropiane të gjeodezisë
5. Qasje në projekte të ndërsjellta, nëpërmjet të cilave do t'u mundësohet pedagogëve, studentëve dhe stafit udhëheqës dhe menaxhues, të kenë mundësi të përfshihen në projekte të përbashkëta që do të ndërmerren nga Kolegji "ESLG" dhe Shoqata e Gjeodetëve të Kosovës;
6. Konkurrimi në projekte të përbashkëta vendore, ndërkombëtare, nëse ndërmjet palëve ekziston vullneti dhe dëshira.

III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuar sipas këtij Memorandumi, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuara me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjëherë palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër.
2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë.

IV. Dispozitat e Fundit

1. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim apo keqinterpretim në realizimin e këtij Memorandumi do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe brenda kuadrit të etikës morale;
2. Ky Memorandum hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit;
3. Ky Memorandum është përpiluar në katër kopje identike, dhe secila palë merë nga dy kopje.

Prishtinë, më 7 gusht 2014

PALET NËNSHKRUESE

Shoqata e Gjeodetëve të Kosovës

Kolegji "ESLG"

Kryetari i Bordit

Kryetari Bordit

Murat Hoxha

Dr. Visar Hoxha

